



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA			
Njësi: Unit:	KD	Nr. Prot.: Prot. No.:	14/2021
Jedësia: Jed. No.:		Br. Prot.:	
Nr. i faqëve: No. of pages:	- 18 -	Data: Date:	01.02.2021
Dr. shënues: Dr. shënues:		Datimi: Prishtinë/ë	

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

RAPORT VJETOR 2020

Oda e Mjekëve të Kosovës



Janar 2021,

Prishtinë

Përmbajtja:

RAPORT VJETOR 2020	1
1. Infrastruktura Juridike.....	3
2. Këshilli Drejtues	3
3. Anëtarësimi	4
4. Mbikëqyrja etiko-profesionale.....	5
5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional.....	8
6. Licencimet	8
7. Edukimi specialistik - zberthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të.....	9
8. Këshilli Mbikëqyrës.....	9
9. Komisioni për çështje Etike i OMK-së.....	9
10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së.....	9
11. Raporti Financiar	10
11.1 Gjendja financiare – 31 dhjetor 2020.....	10
11.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional.....	11
11.3 Prokurimi	11
12. Aktivitete të tjera	12
12.1 Shërbimi profesional.....	12
12.2 Faksimilet me grada shkencore dhe thirrje akademike.....	13
12.3 Kongresi vjetor.....	14
12.4 Botimi i Revistës “Mjeku”.....	14
12.5 Tryeza e rumbullakët “Ligji i pagave dhe Mjekët e papunë”.....	14
12.6 Digjitalizimi i arkivit.....	15
12.7 Marrëveshjet	15
12.8 Bashkpunimi në mes OPSH-ve.....	15
12.9 Bashkëpunimi me institucione	15
12.10 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike.....	16
12.11 Shpallja e Emergjencës së shëndetit publik	16
12.12 Marrëdhënie ndërkombëtare	17
13. Plani i veprimit për 2021	17
Projektet afatmesme dhe afatgjata.....	17

1. Infrastruktura Juridike

Kuvendi i Odës së Mjekëve të Kosovës gjatë vitit 2020 ka mbajtur një mbledhje të rregullt, e cila për shkak të situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19 dhe në respektim të masave dhe rekomandimeve të marra në luftimin e pandemisë COVID-19 është organizuar në mënyrë virtuale përmes platformës ZOOM, ku janë shqyrtuar propozimet amendamentet e akteve juridike të Odës. Mbledhja është mbajtur me datë 25 nëntor 2020, ku u miratuan rregulloret dhe amendamentet për plotësim dhe ndryshim të akteve normative si në vijim:

- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Regjistrimin, Licencimin dhe Rilicencimin e Mjekëve;
- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores së Punës së Komisionit për Çështje Etike;
- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Menaxhimin e Financave të OMK-së;
- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores së Punës së Komisionit për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke; dhe
- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK;
- Miratimi i Rregullores për Marketing në OMK;
- Miratimi i Rregullores për Dhënie dhe Dekorativ dhe Çmimeve vjetore të OMK-së.

2. Këshilli Drejtues

Gjatë vitit 2020, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur 14 takime ku janë pranuar 34 lëndë, nga të cilat janë marrë 18 vendime sipas kërkesave/ankesave të pranuar dhe 1 lëndë është në procedurë e cila mund të përfshijë kërkesë/ankesë apo njoftim.

Sfidat apo vështirësitë të cilat e kanë përcjellë Këshillin Drejtues të OMK-së gjatë vitit 2020 janë:

- Ligji për paga - vendimi i gjykatës kushtetuese - Avokimi i OMK-së
- Bartja e kompetencës për edukimin specialistik

- Sigurimi i parcelës për ndërtesën e OPSH-ve - refuzimi nga SHSKUK për ndarjen e një parcele brenda QKUK-së
- Mungesa e mjeteve të mjaftueshme mbrojtëse gjatë punës së mjekëve gjatë pandemisë - Avokimi i OMK-së
- Përkrahje për dhjetë punimet shkencore më të mira të publikuara përgjatë vitit 2020
- Zbatimi i Ligjit për Shëndetësi dhe Ligjit për OPSH-të.

3. Anëtarësimi

Anëtarësimi në Odën e Mjekëve të Kosovës ka filluar më datë 23 janar 2018. Gjatë vitit 2020 janë anëtarësuar 365 mjekë dhe si rezultat numri total ka arritur në 4429 mjekë, nga të cilët 3226 mjekë janë të punësuar në sektorin publik, 525 mjekë në sektorin privat, 638 mjekë janë të papunë dhe 40 mjekë janë në pension.




Tabela 1. Anëtarësimi deri më 31 dhjetor 2020




Tabela 2. Anëtarët të ndarë sipas moshës

Bazuar në tabelën më lart shihet se moshja mesatare e mjekëve anëtarë është 47 vjeç, anëtari më i ri është 24 vjeç, kurse anëtari më i vjetër është 85 vjeç.

Gjatë vitit 2020 për shkak të moskryerjes së pagesës vjetore të anëtarësisë janë çanëtarësuar 168 mjekë.

4. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të odës, në mënyrë tabelore do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të odës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për vitin 2020	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për vitin 2020	Sanksionet e shqiptuara për vitin 2020	Sanksionet e ekzekutuara për vitin 2020	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	58	94	///	///	16

<p>Këshilli Etik</p>	<p>54</p>	<p>88</p>	<p>Rekomandim kolegjal 41 Qortime publike 7; Gjoha: 10 Gjithsej 4,000.00€</p>	<p>Qortim publik 1 (100.00€) Gjoha 0 (0.00€) Gjithsej 00.00€ Shpenzime të paushallit: 450.00€</p>	<p>10</p>
<p>Gjyqi i Nderit</p>	<p>12</p>	<p>8</p>	<p>Sipas ankesës është anuluar vendimi i Këshillit Etik nr. KE. 67/2020 Sipas ankesës është vërtetuar vendimi i Këshillit Etik nr. KE 02/5/2020 Aprovohet ankesa GJN 05/2020 kundër vendimit të Këshillit Etik KE. 74/29/2020. Hidhësi e paafatshme ankesa GJN. 06/2020 kundër vendimit të Këshillit Etik KE. 74/29/2020. 1.) Refuzohe ankesa GJN 07/2020 Prokuroti të OMK-sëndaj Vendimit të Këshillit Etik</p>	<p>///</p>	<p>2</p>

			<p>KE 27-8/2020.</p> <p>2.)Hidhësi e paafatshme ankesa GJM 09/2020 kundër vendimit të Këshillit Etik KE KE 27-8/2020.</p> <p>3.) Refuzohe ankesa GJM 10/2020 e D Shkelzen Elezaj nda vendimit të Këshillit Etik KE 12-5/2020.</p>		
Certifikatat e të kaluarës etike	109	///	///	///	///

Në shqyrtim të drejtpërdrejtë janë mbajtur pesë seanca të shqyrtimit kryesor në të cilin është mundësuar përfaqësimi i drejtpërdrejtë i palëve në procedurë, përfshirë të drejtën në përfaqësues me autorizim (prokurë). Ndërkaq në procedurën e mjetit juridik, pranë Gjyqit të Nderit, janë ndryshuar katër lëndë si rrjedhojë e paraqitjes së fakteve të reja të cilat nuk janë parashtruar pranë Këshillit Etik.

Vërejtje: Lëndët e pasqyruara në tabelë përfshijnë lëndë që aktualisht ndonjëra prej tyre janë në procedim nga një organ në tjetrin. Për shkak të natyrës së procedurave është e pamundur që të nxirret në total bilanci i lëndëve për shkak të qarkullueshmërisë së lëndës, varësisht nga faza procedurale në të cilën gjendet lënda e tillë.


5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë vitit 2020 ka akredituar 67 aktivitete.



6. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional gjatë periudhës janar-dhjetor 2020, ka organizuar 3 provime të rilicencimit dhe gjithashtu ka lëshuar 769 licenca me kategoritë si në grafikun e më poshtëm:



Nga data e bartjes së kompetencës për licencim, ky komision i ka lëshuar gjithsej 2525 licenca. Në kriteret e Licencimit/Rilicencimit është edhe ndjekja e programeve për edukim të vazhdueshëm profesional ku mjekët janë të obliguar të fitojnë së paku 20 pikë kredituese në vit, gjegjësisht 100 pikë kredituese për 5 vite.

Bazuar në rrethanat e krijuara si pasojë e pandemisë COVID-19 dhe pamundësinë e organizimit të tubimeve shkencore, Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional liron komunitetin e mjekëve nga obligimi i grumbullimit të së paku njëzet pikëve kredituese për vitin kalendarik 2020.

7. Edukimi specialistik - zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të

Dizajnimi dhe fillimi i fazës kalimtare të zbërthimit të kompetencave të edukimit specialistik (zbërthimi ligjor, financiar dhe teknik) është në proces e sipër, duke përfshirë edhe hartimin e UA-së për shkollim specialistik.

8. Këshilli Mbikëqyrës

Në periudhën kohore janar–dhjetor 2020, Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së ka mbajtur shtatë (7) takime ku është bërë shqyrtimi i vendimeve të Këshillit Drejtues - ligjshmëria e tyre konform akteve juridike të OMK-së dhe ligjeve në fuqi.

9. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Në vitin 2020, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar dhe ka shqyrtuar tetë (8) kërkesa për leje hulumtimi. Kërkesat e shqyrtuara janë aprovuar nga Komisioni për Çështje Etike dhe aplikuesëve u janë lëshuar lejet për hulumtim.

10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së

Në vitin 2020, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke ka pranuar tetë (8) kërkesa për përkrahje financiare. Komisioni ka marrë vendim aprovues lidhur me kërkesat e pranuar.

Këshilli Drejtues i OMK-së në procedurë të votimit qarkullues me datë 30 korrik ka marrë vendim për dhurimin e mjeteve financiare në shumë prej 1,000.00 € të dedikuara për familjet e mjekëve që kanë vdekur si pasojë e infektimit me virusin Covid-19. Kësaj iniciative i është bashkangjitur edhe Dr. Talat Gjinolli duke dhënë mbështetje financiare për familjarët në shumë totale prej 2,000.00 euro. Deri më datë 31 dhjetor janë të infektuar me Covid-19 mbi 3300 punëtorë shëndetësor, nga të cilët 1170 janë mjekë, ku 16 mjekë kanë vdekur si pasojë e infektimit me Covid-19.

11. Raporti Financiar

11.1 Gjendja financiare – 31 dhjetor 2020

1.0 Të hyrat:					
1.0.1 Të hyrat e shtyra nga 2019	€ 304,543				
Të hyrat e shtyra nga 2019					€ 304,543
1.1 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	Realizimi: TM3	Realizimi: TM4	TOTAL TM4
1.1.1 Të hyrat nga anëtarësia:					
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€ 232,700	€ 43,250	€ 35,746	€ 16,213	€ 327,909
1.1.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jokosovarë	€ 5,250	€ 2,253	€ 3,500	€ 1,500	€ 12,503
1.1.4 Licencimi	€ 9,420	€ 5,580	€ 9,840	€ 6,540	€ 31,380
1.1.5 Të hyrat e tjera*	€ 10,033	€ 2,830	€ 9,581	€ 8,161	€ 30,605
Të hyrat nga TM3	€ 257,403	€ 53,913	€ 58,667	€ 32,414	€ 402,397
Të hyrat e shtyra nga 2019					€ 304,543
TOTAL TË HYRAT					€ 706,940
2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	Shpenzimet: TM3	Shpenzimet: TM4	TOTAL TM4
2.1 Paga, mëditje dhe kontributet pensionale	€ 37,268	€ 30,986	€ 37,409	€ 49,405	€ 155,068
2.2 Material shpenzues	€ 1,616	€ 603	€ 268	€ 1,312	€ 3,799
2.3 Reprerentacioni	€ 282	€ 151	€ 476	€ 482	€ 1,392
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€ 4,699	€ (1,410)	€ 4,070	€ 9,800	€ 17,159
2.5 Shpenzimet e tjera*	€ 4,810	€ 7,848	€ 5,518	€ 4,592	€ 22,768
2.6 Shpenzimet e asetëve	€ 1,878	€ 102	€ 980	€ 8,288	€ 11,248
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€ 6,600		€ 9,000	€ 4,000	€ 19,600
TOTAL SHPENZIMET	€ 57,153	€ 38,280	€ 57,721	€ 77,879	€ 231,033
BILANCI PER TM	€ 200,250	€ 15,633	€ 946	€ (45,464)	€ 475,907
BILANCI ME 31.12.2020					€ 475,907

1.1.5* Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, faksimili, faksimili i dytë, kongreset, simpoziumet, seminarët, konferencat vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare, aktivitetet e organizuara nga kompanitë farmaceutike, certifikatat për të kaluarën etike, lejimi për hulumtime biomjekësore për anëtarë të Odës, të hyrat nga dënimet (masat disiplinore), dhurata/donacione, të ardhurat të tjera.

2.5 *Faksimili, anëtarësimi në CPME, shpenzimet e tel., shpenzimet e int., shpenzimet e postës, pajisje të TI-së, shpenzime bankare, shpenzimet e pastrimit, shpenzimet e transportit, inventari, shpenzimet e tjera operative.

2.7*Tek përkrahja për solidaritet përveç mjeteve të ndara për mjekët të cilët kanë lënguar nga ndonjë sëmundje, janë të përfshira edhe mjetet e ndara për familjet e mjekëve të cilët kanë ndërruar jetë si pasojë e infektimit me virusin COVID-19, bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues me nr. Ref. 53/20.

11.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Mjekëve të Kosovës gjatë vitit 2020 ka përkrahur financiarisht 4 aktivitete grupore për Edukim të Vazhdueshëm Profesional, ka dhënë përkrahje financiare për 10 punimet më të mira si dhe botimin e Studimit mbi praksën e dyfishtë të punëtorëve shëndetësorë (publikë dhe privatë). Vlera totale e aktiviteteve të përkrahura është 15,160.00 €.

- Kongresi i parë Ndërkombëtar i Kolegjit të Kirurgëve të Kosovës në vlerë prej 2.000.00 €. Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, aktiviteti nuk është mbajtur, por janë financuar vetëm 590.00 € shpenzimet fillestare për mbajtje të aktivitetit, kurse pjesa tjetër e shumës në vlerë prej 1,410.00 € është rimbursuar.
- Shoqata e Kirurgëve Torakalë të Kosovës në organizimin e Punëtorisë me VATS/Kirurgjia minimal invasive, në vlerë prej 2,000.00 €.
- Qendra e Mjekësisë Urgjente Prishtinë në organizimin e punëtorisë për përpunimin dhe adaptimin e grupit të tretë të udhërrëfyesit të punës për përdorim të brendshëm, në vlerë prej 700.00 €.
- Shoqata e Kirurgëve Plastikë, Rekonstruktivë dhe Estetikë të Kosovës në vlerë prej 2,000.00 €. Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, aktiviteti nuk është mbajtur dhe mjetet janë kthyer në llogarinë e Odës.
- Botimi i Studimit mbi praksën e dyfishtë të punëtorëve shëndetësorë (publikë dhe privatë) në vlerë prej 2,070.00 €
- Përkrahje për dhjetë punimet shkencore më të mira të publikuara përgjatë vitit 2020 me vlerë 10,000.00 €
- Asociacioni Kosovar i Anesteziologëve në vlerë prej 1,800.00 €.

11.3 Prokurimi

Gjatë vitit 2020 u zhvilluan gjashtë procedura të hapura të prokurimit:

Procedura e hapur e prokurimit për Furnizim me material shpenzues në zyrat e OMK-së u zhvillua deri në fazën ku për shkak të mungesës së aplikimeve u bë anulimi i saj. Ftesa për Tender për furnizim me material shpenzues për zyrat e OMK-së u rishpall me Vendim të Këshillit Drejtues në muajin shkurt, dhe kësaj radhe procedura e prokurimit u zhvillua me sukses.

Në muajin maj u bë ftesa për tender nga Oda e Mjekëve të Kosovës për të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin ofertën e tyre për dosje të tenderit për Përkthim dhe lektorim të materialeve të OMK-së. Si rezultat i kësaj ftese janë pranuar oferta nga tre operatorë ekonomikë, mirëpo Komisioni i vlerësimit ka konstatuar se dy aplikues nuk kanë qenë të përgjegjshëm. Andaj Komisioni i

vlerësimin të tenderit ka vendosur se për këtë procedurë të prokurimit nuk janë plotësuar kushtet për të vazhduar procedurën e mëtutjeshme dhe si rrjedhojë u bë anulimi i procedurës. Ftesa për Tender për Përkthim dhe lektorim të materialeve të OMK-së u rishpall dhe si rezultat i kësaj ftese kësaj radhe procedura e prokurimit u zhvillua me sukses.

Në muajin gusht u bë ftesa për tender nga Oda e Mjekëve të Kosovës në mënyrë që të gjitha kompanitë e interesuara të paraqesin ofertën e tyre për dosje të tenderit për furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative të OMK-së. Si rezultat i kësaj ftese u pranuan vetëm dy oferta nga operatorë ekonomikë, dhe për shkak të mospërmbushjes së kushtit për zhvillim të procedurës së prokurimit u bë anulimi i procedurës. Ftesa për Tender për furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative të OMK-së u rishpall me Vendim të Këshillit Drejtues në muajin shtator, dhe kësaj radhe procedura e prokurimit u zhvillua me sukses.


Gjithashtu, në muajin korrik, bazuar në ofertat të pranuar, është bërë furnizimi i zyrave të OMK-së me pajisje kondicioner.

12. Aktivitete të tjera

12.1 Shërbimi profesional

Pas aprovimit të organogramit nga Këshilli Drejtues, gjatë vitit 2020 sipas konkursit të hapur janë përzgjedhur një Nëpunës i jashtëm për Teknologji Informative dhe një Asistente Administrative pranë Komisioneve të Përhershme.

ORGANOGRAMI I SHËRBIMIT PROFESIONAL TË OMK-SË



12.2 Faksimilet me grada shkencore dhe thirrje akademike

Kuvendi i Odës së Mjekëve të Kosovës më datë 17 dhjetor 2019 ka mbajtur mbledhjen e rregullt ku janë shqyrtuar propozim-amendamentet e akteve juridike të Odës. Në kuadër të këtij takimi u miratuan amendamentet për plotësimin dhe ndryshimin e akteve normative, ku ndër të tjera është amendamentuar Neni 24 i Rregullores për Regjistrimin, Licencimin dhe Rilicencimin e Mjekëve, i cili parasheh përmbajtjen e faksimilit. Në këtë rast Kuvendi ka aprovuar që në faksimil të shtohen edhe gradat shkencore dhe thirrjet akademike për ata që posedojnë atë.

Si rezultat janë aprovuar 259 faksimila me grada shkencore dhe thirrje akademike përgjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

12.3 Kongresi vjetor

Ndër aktivitetet kryesore që Oda e Mjekëve ka planifikuar të realizojë për vitin 2020 është Kongresi Mjekësor.

Në fillim të vitit 2020 Këshilli Drejtues kishte marrë vendim që Kongresi vjetor i organizuar nga Oda të mbahet më 16 dhe 17 tetor 2020. Kongresi ishte planifikuar të jetë i fokusuar në lëminë e Onkologjisë ndërdisiplinare. Më 11 mars u zgjodh Këshilli Organizativ i përbërë nga 13 anëtarë përgjegjësi kryesore e të cilit do të jetë organizimi dhe mbarëvajtja e punimeve të Kongresit vjetor.

Për shkak të respektimit të masave të marra mbrojtëse për parandalimin dhe trajtimin e virusit pandemik COVID-19 organizimi i Kongresit vjetor është shtyrë deri në heqjen e masave mbrojtëse të marra nga Qeveria e Kosovës.

12.4 Botimi i Revistës “Mjeku”

Me propozim të Këshillit Drejtues në mbledhjen e kuvendit të OMK-së u mor vendim për themelimin e Revistës shkencore të Odës së Mjekëve të Kosovës.

Me 2 mars Këshilli Drejtues emëroi anëtarët e redaksisë së revistës, ku si rrjedhojë me datë 9 mars u mbajt takimi i parë i anëtarëve. Në takimin e parë u vendos që revista të jetë informative, të botohet dy herë në vit dhe u propozua që numri i parë të botohet me datë 1 qershor. Për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID-19, botimi i revistës është shtyrë deri në stabilizim të situatës bazuar në rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik.

Me datë 28 dhjetor 2020 u mbajt takimi i dytë i anëtarëve të revistës, ku u strukturua përmbajtja e revistës, si dhe u vendos që revista të botohet në mënyrë elektronike në mënyrë që të arrijë audiencë sa më të gjerë.

12.5 Tryeza e rrumbullakët “Ligji i pagave dhe Mjekët e papunë”

Me datë 17 Qershor Oda e Mjekëve të Kosovës organizoi tryezën e rrumbullakët me temë 'Ligji i pagave dhe Mjekët e papunë'. Qëllimi i organizimit të tryezës ishte që të mbledhë akterët kyç të sektorit shëndetësor për të diskutuar rreth shqetësimit për numrin e madh të mjekëve të papunë, ikjen e tyre nga Kosova dhe nevojat e sistemit shëndetësor për mjekë sipas specializimeve. Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin edhe deputetja dhe kryetarja e komisionit për shëndetësi në kuvendin e

Kosovës Dr. Albena Reshitaj, përfaqësues të ministrisë së shëndetësisë, ministrisë së financave, kryetarë të odave të profesionistëve shëndetësorë, kryetari i federatës së sindikatave të shëndetësisë së Kosovës, dhe përfaqësues të mjekëve specialist të papunë. Lejimi i pranimi të numrit të ri të mjekëve, 100 mjekë specialist (74 zëvendësime dhe 26 vende të reja të punës) për vitin 2020, hapja e konkursit për 300 pozita për shkollim specialistik dhe rishqyrtimi i buxhetit, kalkulimi bazuar në ligjin për paga janë disa nga rekomandimet e dala nga kjo tryezë.

12.6 Digjitalizimi i arkivit

Në muajin tetor ka filluar digjitalizimi i arkivës së anëtarësimeve, ku në fund të muajit dhjetor ka përfunduar pjesa e parë dhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 planifikohet të përfundojë edhe Arkiva e EVP-së dhe Licencimeve. Në mbështetje të stafit profesional për realizimin e këtij projekti janë angazhuar dy praktikantë.

12.7 Marrëveshjet

Me 16 janar 2020 është lidhur marrëveshje bashkëpunimi në mes të Odës së Mjekëve të Kosovës dhe Kosova's Organization of Medical Students KOMS. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është krijimi i bashkëpunimit përmes të cilit palët shprehin interesim të punojnë së bashku për integrimin e studentëve dhe profesionistëve kosovarë të fushave të shëndetit dhe mirëqenies në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim të ngritjes profesionale, zhvillimit të shkencave mjekësore dhe përmirësimit të jetës sociale të qytetarëve.

12.8 Bashkëpunimi në mes OPSH-ve

Në kuadër të bashkëpunimit në mes të OPSH-ve, gjatë tremujorit të katër 2020 u zhvilluan takime të vazhdueshme në mes të kryetarëve të OPSH-ve, ku me iniciativë të Odës së Mjekëve të Kosovës me mbështetjen e odave të tjera të profesionistëve shëndetësorë është marrë iniciativa për ngritjen e obeliskut kushtuar punëtorëve shëndetësorë për punën dhe angazhimin e tyre gjatë pandemisë.

12.9 Bashkëpunimi me institucione

Me datë 04 nëntor, Oda e Mjekëve ishte pjesë e tryezës e rrumbullakët (virtuale) në kuadër të projektit “Shkëmbimet me Diasporën mbi Reagimin ndaj COVID-19”. Projekt i organizuar nga GERMIN me mbështetjen e Friedrieich Ebert Stiftung, për qëllim kishte të identifikojë problemet dhe nevojat akute të sektorëve kyç të institucioneve kosovare të shkaktuara nga COVID-19, për t’i prezantuar pastaj tek profesionistët dhe palët e interesit nga diaspora më qëllim të shqyrtimit të mundësive për ndërveprim.

Me datë 22 dhjetor kryetari i OMK-së ishte pjesë e tryezës së diskutimit organizuar nga Institute of Southeast Europe for Health and Social Policy me temë: “Ikja e trurit (Brain Drain) të profesionistëve të kujdesit shëndetësor në Kosovë”, ku u ngritën çështjet: Cilat janë shkaqet kryesore të migrimit të profesionistëve të kujdesit shëndetësor? Si ta parandalojmë dhe zvogëlojmë ndikimin e tij negativ në sektorin e shëndetësisë në Kosovë?

Oda e Mjekëve të Kosovës ka dhënë mbështetje dhe përkrahje në zbatimin e Studimit ‘Vlerësimi i mirëqenies psikologjike të punonjësve shëndetësorë gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë’, të kryer nga Departamenti i Psikologjisë i Universitetit të Prishtinës.

12.10 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional lidhur me veprimtarinë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Gjykatat dhe prokuroritë publike të Kosovës, ka caktuar ekspertë apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës. Ekspertiza të tilla kanë qenë në shërbim të konstatimit të përgjegjësisë individuale të mjekëve të cilët i janë nënshtruar procedurave penale apo civile, qoftë në fazën hetimore apo gjatë shqyrtimeve gjyqësore.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për vitin 2020	Vendimet sipas urdhëresave të pranuar për vitin 2020	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për vitin 2020	Lëndët e bartura nga periodat paraprake
Kryetari i Odës	6	1	1	4	3

12.11 Shpallja e Emergjencës së shëndetit publik

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 15 mars 2020, shpalli emergjencën për shëndetin publik, si dhe morri vendimin nr. 01/09 sipas të cilit janë përcaktuar masat mbrojtëse për parandalimin dhe trajtimin e virusit pandemik COVID-19. Me qëllim të zbatimit të vendimit dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë së OMK-së, nga data 16 mars 2020, OMK-ja ka pezulluar punën me palë pranë selisë së saj, kështu që zyrat e selisë së OMK-së kanë qenë të mbyllura deri me datë 12 maj 2020. Të gjitha shërbimet e mundshme për anëtarët

e OMK-së janë rekomanduar që gjatë kësaj kohe të bëhen përmes ueb faqes zyrtare të OMK-së dhe postës zyrtare elektronike të OMK-së.

12.12 Marrëdhënie ndërkombëtare

Në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare Oda e Mjekëve të Kosovës ka marrë pjesë në këto takime:

- Takimi virtual të organizuar nga (CPME), “Menaxhimi i situatës të shkaktuar nga COVID-19”
- Raportime të rregullta të CPME me qëllim të koordinimit me vendet tjera lidhur me menaxhimin e përgjithshëm të COVID-19 në Kosovë (mbrojtja ndaj COVID-19 dhe mjetet mbrojtëse të në dispozicion për mjekë, protokollat, numri i testeve, llojet e barnave, hapësirat e disponueshme për pacientët dhe informata të tjera)
- Simpoziumi i 27-të i ZEVA “Përballja me pandeminë Covid-19, sfidat dhe përvojat e vendeve të ndryshme”
- Takimi i Forumit Evropian të shoqatave mjekësore (EFMA).

13. Plani i veprimit për vitin 2021

Projektet afatmesme dhe afatgjata

- Projekti për ndërtimin e një objekti për të gjitha OPSH-të, mbështetur nga MSH-ja, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë”. Kësaj iniciative i janë përgjigjur të gjitha OPSH-të dhe kërkesa zyrtare për mbështetje është nënshkruar nga të gjitha ato dhe më pas është dorëzuar në MSH. Fillimi i ndërtimit pritet të fillojë pas miratimit të marrëveshjes për vazhdimin e projektit të KSV/017 nga Kuvendi i Kosovës.
- Pas miratimit të kërkesës nga OMK drejtuar LuxDev-it lidhur me përkrahjen financiare për zhvillimin e sistemit informativ/bazës interaktive të të dhënave, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohëzgjatja e projektit është 1 vit.
- Zbërthimi dhe bartja e kompetencave për edukimin specialistik bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të.
- Botimi i Revistës “Mjeku”
- Organizimi i Kongresit të II vjetor multidisiplinar me fokus onkologjinë
- Organizimi i Kongresit të III multidisiplinar
- Organizimi i Konferencës ndërkombëtare të Bioetikës

- Organizimi i zgjedhjeve për legjislaturën e III-të të OMK-së